

TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET NGA MONITORIMI I KONTRATËS PËR ULËSET E KOMUNËS SË PRIZRENIT



Komuna e Prizrenit ka kontraktuar katër modele të ulëseve, që për nga pamja dukeshin të njëjta dhe që të gjitha janë pjesë të një kontrate. Dallimi ishte te veshjet e ndryshme anti-korozive, e që çmimet dalloni për gati 1000%.

Komuna e Prizrenit kishte buxhet vetëm 20,000.00 €, **ndërsa kishte shpallur një tender me vlerë prej 1,700% më të lartë**, respektivisht 360,000.00 €.




Në kontratën e nënshkruar, **çmimet për ulëse dallonin deri në 9,900 %**.


Ulëset me çmimet prej 995 € **kanë filluar të korrodohen ende pa mbushur 1 vit**.




**Modeli 1
995 €**




**Modeli 2
11 €**



**Modeli 3
48 €**



**Modeli 4
48 €**



REKOMANDIMET

Kryetari i Komunës të siguroj që komuna të mos hyjë në detyrime më të larta se buxheti i aprovuar dhe planifikimi i prokurimit.

Kryetari i Komunës të siguroj mekanizma mbikëqyrës dhe llogaridhënës për të siguruar se menaxherët e kontratave janë duke menaxhuar e to në përputhshmëri me detyrimet kontraktuale.

Kryetari i Komunës të inicioj procedurat ligjore për ndëshkimin e operatorit ekonomik për mashtrim në implementimin e kontratës publike.

Prokuroria Themelore në Prizren të inicioj hetime ndaj Komunës së Prizrenit për dyshimet lidhur me çmimet e kontraktuara dhe ulëset nën kriteret e kontratës të lejuara nga komuna për shfrytëzim publik, dhe të paguara nga buxheti publik.